



REPUBLIKA E SHQIPERISE
INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË
Nr. 140 Prot.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPËRISË
Nr. 3511 Prot.

AKT - MARRËVESHJE

Në Tiranë, sot, më datë 1.07.2004, lidhet kjo akt marrëveshje, ndërmjet:

Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, i cili më poshtë do të quhet **ILDKP**, i përfaqësuar nga Inspektori i Përgjithshëm, znj. Fatmira Laska;

dhe

Bankës së Shqipërisë, i cili më poshtë do të quhet **BSH**, i përfaqësuar nga Guvernatori, z. Shkëlqim Cani.

Të dy subjektet nënshkruese të kësaj akt- marrëveshje, me qëllim:

realizimin e komunikimit dhe shkëmbimit të të dhënave që lidhen me procesin e deklarimit dhe kontrollit të pasurive dhe detyrimeve financiare;

ritjen e efikasitetit dhe bashkrendimin e punës ndërmjet institucioneve për kontrollin e deklaratave të pasurisë dhe detyrimeve financiare;

koordinimin e punëve dhe aktiviteteve të përbashkëta institucionale në kuadrin e parandalimit të korrupsionit dhe të luftës kundër tij;

bien dakort si më poshtë:

1. Të dyja institucionet angazhohen se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje në frymën e nenit 26 të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë".

2. BSH angazhohet që të vërë në dispozicion të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive çdo informacion apo të dhënë që disponon ky institucion dhe ato të vartësisë, që lidhen me kontrollin dhe

verifikimin e të dhënave të deklaratës së pasurisë dhe detyrimeve financiare.

Gjatë komunikimit dhe vënies në dispozicion të të dhënave të kërkuara, BSH dhe ILDKP do të respektojnë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në rregulloren nr.53, datë 21.06.2000, të Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë "Mbi Transparencën dhe Konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë" si dhe në udhëzimin e Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë "Mbi klasifikimin e informacionit jopublik në Bankën e Shqipërisë".

3. BSH do të caktojë një strukturë të posacme si pikë kontakti me ILDKP, në mënyrë që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

4. Kërkesa për shkëmbimin e të dhënave do të bëhet në cdo rast me shkresë të Inspektorit të Përgjithshëm. BSH merr përsipër që, jo më vonë dhe 15 ditë nga marrja e kërkesës, të vërë në dispozicion të personit të autorizuar nga ILDKP, të dhënat e kërkuara. Në cdo rast të dhënat do të jenë shkresore. Ato duhet t'i përgjigjen drejtpërdrejt kërkesës së bërë dhe nuk duhet të jenë të përgjithshme.

5. Në raste të caktuara, kur vërehet se bankat e nivelit të dytë nuk do të mundësojnë dhënien e informacionit të kërkuar nga ILDKP-ja, Banka e Shqipërisë me cilësinë e autoritetit mbikqyrës të sistemit bankar, do të mbështesë ILDKP-ën duke kërkuar nga bankat e nivelit të dytë zbatimin me përpikmëri të ligjit.

6. Kjo marrëveshje nënshkruhet sot më datë 1.07.2004 dhe fillon zbatimin e saj menjëherë.

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT
DHE KONTROLLIT TË PASURISË**

Inspektori i Përgjithshëm

FATMIRA LASKA



BANKA E SHQIPËRISË

Guvernatori

SHKËLQIM CANI

